



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-30804/24
Kaçanik, 24.12.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17, 24 dhe 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 6.2 lidhur me nenin 61 dhe 34.5 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvend të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 24 dhjetor 2024, merr këtë:

VENDIM

PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË PARAQITURA TE QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Lejohet financimi i shpenzimeve të varrimit në shumën **300.00€** ((treqind euro) për të gjitha rastet mortore të paraqitura të qytetarët e komunës së Kaçanikut.
2. Financimi në tërësi i shpenzimeve të caktuara të varrimit për të gjitha rastet e paraqitura deri në shumën e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, do të përfshijë këto shërbime:
 - 2.1 Lajmërimi (temxhiti);
 - 2.2 Pastrimi dhe ruajtja e kufomës në morg (lokacionet ekzistuese në komunën tonë);
 - 2.3 Sigurimi i dërrasave;
 - 2.4 Sigurimi i mbështjellësit (qefini);
 - 2.5 Ceremonia e faljes së kufomës;
 - 2.6 Transporti i kufomës brenda territorit të Kosovës;
 - 2.7 Hapja dhe mbulimi i varrit;
 - 2.8 Piramida (mbishkrimi i emrit dhe mbiemrit).
3. Te rastet mortore të kategorisë së Veteranëve të luftës së UÇK-së parashihet **financimi shtesë** në shumë **175€** (njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) për secilin rast mortor të kësaj kategorie duke përfshirë shërbimet shtesë:
 - 3.1 Sigurimi i arkivolit; dhe
 - 3.2 Sigurimi i flamurit kombëtar.
4. Mjetet buxhetore nga pika 2 dhe 3 të këtij Vendimi do të merren nga kategoria e Subvencioneve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
5. Me këtë Vendim, qytetarët nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë ndaj bashkësive fetare.

6. Bashkësitë fetare nuk mund t'i kushtëzojnë qytetarët, me pagesën e anëtarësisë, kryerjen e shërbimeve të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi.

7. Me rastin e aprovimit të këtij Vendimi, konform rregullave ligjore të shpenzimit të parasë publike, do të ekzekutohen mjetet në shumën e paraparë sipas pikës 1 dhe 3 për çdo rast mortor të paraqitur te qytetarët e komunës së Kaçanikut, pa dallim të përkatësisë fetare.


8. Për zbatimin e Vendimit do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi **01-Nr. 104/02-1514/19** i datës 29.01.2019 dhe Vendimi **01-Nr.07-104/02-15302/20** i datës 21.07.2020 për ndryshim plotësimin e Vendimit 01-Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve për rastet mortore të paraqitura te qytetarët e komunës së Kaçanikut.

10. Ky Vendim, pas aprovimit në Kuvend komunal, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë propozim-vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë);
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republie of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01-Nr. 104/02-1514/19
Kaçanik; 29.01.2019

Në mbështetje të nenit 12, 17 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), nenit 6.2 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 29 Janar 2019, mori këtë:

VENDIM

PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË PARAQITURA TË QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, Lejohet financimi i shpenzimeve të varrimit në shumë 175.00€ për secilin rast mortor të paraqitur të qytetarët e Komunës së Kaçanikut.
2. Financimi në tërësi i shpenzimeve të caktuara të varrimit për të gjitha rastet e paraqitura deri në shumën e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, përfshinë këto shërbime:
 1. Lajmërimi (temxhif),
 2. Pastrimi dhe ruajtja e kufomës në morg (lokacionet ekzistuese në komunën tonë),
 3. Sigurimi i dërrasave,
 4. Sigurimi i mbështjellësit (qefini),
 5. Ceremonia e faljes së kufomës,
 6. Transporti i kufomës brenda territorit të Republikës së Kosovës,
 7. Piramida (mbishkrimi i emrit dhe mbiemrit).
3. Mjetet buxhetore nga pika 2. të këtij Vendimi do të merren nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.
4. Me këtë Vendim, qytetarët e Komunës së Kaçanikut, nuk lirohen nga pagesa e anëtarësisë ndaj bashkësive fetare.
5. Bashkësitë fetare nuk mund t'i kushtëzojnë qytetarët e Komunës së Kaçanikut, me pagesën e anëtarësisë, për kryerjen e shërbimeve të cekura në pikën 2. të këtij Vendimi.
5. Çmimet për shërbimet nga pika 2 e këtij Vendimi, raportimi për mjetet e shpenzuara si dhe çështje të tjera të cilat nuk janë potencuar me këtë vendim, do të rregullohen me marrëveshje të Kryetarit të Komunës dhe Bashkësive fetare, e cila marrëveshje do të jetë pjesë përbërës e këtij Vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ndërsa ekzekutimin financiar do ta bëjë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
7. Ky Vendim lry në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës MAPI.-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim, njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Arkivi.

Kryesposi i Kuvendit
Këmal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republie of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 07-104/02-15302/20
Kaçanik, 21.07.2020

Në mbështetje të nenit 12, 17 lidhur me nenin 40.2 të Ligjit nr. 03/L-040-Për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), nenit 6.2 lidhur me nenin 61.1 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 1Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 21 Korrik 2020, mori këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01 NR.104/02-1514/19 TË DATËS 29.01.2019
PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT PËR RASTET MORTORE TË
PARAQITURA TE QYTETARËT E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës 01 Nr.104/02-1514/19 datë 29.01.2019- Për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet e paraqitura të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e Vendimit nga pika 1 e këtij Vendimi, bëhen të pika 1 dhe të pika 2 si vijon:
 - 2.1. Të Pika 1. Shtohet paragrafi 1.1 me tekstin si vijon:

” Te rastet mortore të kategorisë së Veteranëve të luftës së UÇK-së parashihet financimi shtesë në shumë 175€ (njëqind e shtatëdhjetë e pesë euro) për secilin rast mortor të kësaj kategorie”.
 - 2.2. Të pika 2, shtohet paragrafi 2.1. me tekstin si vijon:

“Te rastet mortore të kategorisë së Veteranëve të luftës së UÇK-së përfshihen shërbimet shtesë:

 - 2.1.1 Sigurimi i arkivolit; dhe
 - 2.1.2 Sigurimi i flamurit kombëtar.
3. Pikët tjera të vendimit mbesin të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe 7 pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Me këtë propozim të vendimit njoftohen:

1. Kryetari i Komunës.
2. Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
3. Drejtorja për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim; dhe
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kempal Merseli



Nr: 124/24 Data: 21.11.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	21.11.2024	Vendi	Kaçanik
	Obj. org.		Numri	Shitje
				01-104/02-29480/24

Për:	Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Kuvendin Komunal dhe Kryetarin z. Besim Ilazi
Nga:	Këshilli i Bashkësisë Islame - Kaçanik
Lënda:	Kërkesë për Shërbimet e Varrimit
Data:	21.11.2024

I nderuar titull i lartshënuar,

Këshilli i Bashkësisë Islame në Kaçanik duke parë ngritjen e çmimeve në përgjithësi si dhe kërkesat e shumë qytetarëve në veçanti, vendosi që t'ju drejtohet me këtë kërkesë:

Komuna e Kaçanikut deri më tani ka paguar shpenzimet për shërbime të varrimit për qytetarët në vlerë prej 175 euro.

Këshilli i Bashkësisë Islame i Kaçanikut është falënderues ndaj Komunës së Kaçanikut për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për shërbimet të cilat i keni kryer ndaj qytetarëve tanë, andaj kërkojmë mirkuptimin tuaj për ngritjen e çmimeve për Shërbimet e Varrimit.

Këshilli i Bashkësisë Islame i Kaçanikut deri më tani ka kryer këto shërbime në mënyrën më të mirë duke u bazuar në marrveshjen e lidhur me komunën e Kaçanikut.

Më poshtë do t'ju paraqesim shërbimet të cilat i kryen K.B.I e Kaçanikut për të qenë transparent me ju dhe qytetarët e komunës tone, si dhe kërkesa për rritje me çmime të reja.

Shërbimet e Varrimit të cilat i kryen Këshilli i Bashkësisë Islame në Kaçanik dhe çmimet:

1. Temxhiti (Lajmërimi për të vdekurin): 5 Euro.

Imami e ka obligim që në momentin që ndërron jetë një qytetarë të bëjë njoftimin në xhaminë e tij.

2. Pastrimi i të Vdekurit: 50 Euro.

Në pastrimin e të vdekurit bëjnë pjesë edhe sigurimi i dorëzave, fashave, maska për fytyrë, sapun - shampun dhe mirëmbajtja e Gasalës (vendi ku pastrohet i vdekuri) etj.

3. Qefini (Mbështjellja e të vdekurit me pëlhurë): 20 Euro.

Pëlhura - qefini përbëhet prej 3 pjesëve në dimension deri në 7 metra.

4. Ceremonia Fetare - Varrimi: 30 Euro.

Në këtë ceremoni përfshihen si: Falja e xhenazes, këndimi i Kuranit, Duaja dhe Talkini i të vdekurit.

5. Transporti: 70 Euro.

Në vlerën e transportit hyjnë këto shpenzime si: Transporti i të vdekurëve në qytet dhe nëpër të gjitha fshatrat (Një transport) duke përfshirë edhe në spitale QKUK - Prishtinë, Ferizaj apo kudo në Kosovë.

Këtu përfshihen: Sigurimi - regjistrimi, mirëmbajtja e automjetit, si dhe pagesa e shoferit me orar 24h, etj.

6. Hapja e Varrit: 80 Euro.

Në këtë shërbim përfshihen si: Hapja e Varrit dhe pagesa e kontributeve të punëtorit.

7. Piramida (Mbishkrimi i Emrit dhe Mbiemrit): 15 Euro.

Këtu përfshihet një dërrasë e drurit e me ngjyrë jeshile të cilës i shkruhet emri dhe mbiemri i të vdekurit dhe viti kalendarik dhe shërbimi.

8. Dërrasat: 30 Euro.

Dërrasat shërbejnë për mbulimin e kufomës pasi lëshohet në tokë. Janë me këto dimensione: Gjatësia 2.20cm, gjërësia 1.20cm dhe trashësia 5cm.

Kjo është pasqyra e përgjithëshme e shërbimeve të varrimit që duhen të kryhen në rast ceremonie varrimi, vlera e të cilës është **Gjithësej: 300 Euro.**

Shpresojmë se kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptim dhe njëherit ju përsërisht me Eselamu Alejkum - Paqa dhe Mëshiraje Allahut qoftë mbi ju!



Kryetari i K.B.I - së, Kaçanik

Fidajim ef. Fazliu

2024